

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

Për aktivitetin e prokurimit:

Nr. i Prokurimit¹	215/33600-26-1353-2-2-1
Nr i brendshëm	

Sa i përket tenderit për: **“Servisimi dhe mirëmbajtje e paisjeve te kuzhinave për Institucionet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore”.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ALY Group SH.P.K; AR-Tech SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Enver Maloku, p.n.,

(Adresa)

Fushë Kosovë, Prishtinë

20000

(Vendi)

(Kodi postar)

+ 383 48 856 854

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Kastriot Gerguri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

alygroup6@gmail.com

(Adresa elektronike)

08.06.2026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 19.03.2026
Data e hapjes së ofertave: 14.04.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 22.05.2026
Kërkesa për rishqyrtim dt. 26.05.2026
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim dt:29.05.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Procesi i hapjes është bërë nëpërmes platformës E-Prokurimi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkangjitur keni kërkesën për rishqyrtim dhe vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 72 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.
Neni 43 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik.

** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt.22.05.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin:

Nuk keni ofruar dëshmi për kërkesat:

Te kapaciteti teknik administrative dhe profesionale:

Nuk keni ofruar referenca për furnizime të ngjashme sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit (DT). Edhe pas kërkesës për sqarime shtesë, Grupi i operatorët ekonomikë nuk kanë dorëzuar dëshmi që vërtetojnë realizimin e furnizimeve të ngjashme, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në DT.

Fillimisht po e sqarojmë se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, autoriteti kontraktues me dt.27.04.2026 na ka kërkuar sqarime shtesë ku në lidhje me kontratat e përfunduara është specifikuar:

Janë paraqitur disa referenca, mirëpo mungojnë dëshmi për furnizime të ngjashme të realizuara gjatë tri (3) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në vlerë jo më pak se 150,000.00 €.

Konform kërkesës së AK-së, ne i kemi kthyer përgjigje të njëjtës dhe i kemi bashkangjitur të gjitha dëshmitë e kërkuara nga e njëjta, e të cilat dëshmi kanë qenë të bashkangjitura edhe në ofertë me rastin e ofertimit. Ne me sqarime shtesë e kemi sqaruar qartë se në ofertë kemi prezantuar kontrata të realizuara në tri vitet e fundit të cilat e tejkalojnë vlerën prej 150,000.00 euro të kërkuar nga ana e AK-së në dosje të tenderit.

Me sqarime shtesë në deklaratën të cilën e kemi dorëzuar ne e kemi sqaruar qartë se kontratat e paraqitura tek lista e kontratave dhe dëshmitë e prezantuara përfshijnë:

Servisimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve termike dhe mekanike;

Mirëmbajtjen dhe riparimin e pajisjeve elektro-mekanike;

Ndërhyrje teknike në sisteme që funksionojnë me ngrohje, presion dhe energji elektrike.

Po ashtu në deklaratë e kemi sqaruar se këto kontrata përfshijnë komponentë dhe procese teknike të ngjashme si:

-Rezistenca ngrohëse, valvula, sisteme elektrike dhe kontrolli, elemente të transmetimit të nxehtësisë, frigoriferë, kushineta, ndërprerësa, pjesë elektrike, vaj dhe ujë.

Pra ne e kemi sqaruar dhe dëshmuar me fakte konkrete se kontratat e dorëzuara nga ana jonë si grup i OE, janë kontrata të cilët kanë të bëjnë me natyrën e njëjtë apo të ngjashme të këtij aktiviteti të prokurimit si në aspektin teknik ashtu edhe në përvojën profesionale.

Pavarësisht kësaj, Autoriteti Kontraktues në vendimin për eliminim vetëm ka përsëritur të njëjtin arsyetim fillestar, pa dhënë asnjë sqarim konkret se cilat dokumente apo cilat pjesë të sqarimeve tona nuk janë pranuar ose pse nuk janë konsideruar të mjaftueshme.

Duhet sqaruar fakti se arsyetimi i autoritetit kontraktues është po ashtu edhe i paqartë sepse nuk është sqaruar se përse nuk janë marrë parasysh kontratat e prezantuara nga ana jonë, përkatësisht nuk është sqaruar se përse kontratat nuk janë cilësuar si kontrata të ngjashme.

Pas kërkesës për sqarime shtesë nga AK, ne kemi vepruar në tërësi sipas kërkesës së tyre dhe kemi dorëzuar sqarime shtesë me shkrim, ku kemi sqaruar në detaje natyrën e kontratave dhe lidhshmërinë e tyre me kërkesat e dosjes së tenderit. Megjithatë, AK nuk ka analizuar në detaje sqarimet tona dhe nuk ka bërë analizë konkrete të dokumenteve të dorëzuara sepse nëse do të analizoheshin në tërësi dokumentet e dorëzuara nga ana jonë, atëherë shumë lehtë do të vërtetohej fakti se ne e plotësojmë kërkesën e dosjes së tenderit.

Për më tepër, kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë që duhet të ofrohen kontrata të ngjashme dhe jo kontrata të natyrës së njëjtë, ndërsa kontratat tona përmbushin aspektin teknik, funksional dhe profesional të kërkuar.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për eliminimin tonë është, i pabazuar në fakte konkrete dhe i pambështetur në dispozitat përkatëse të prokurimit publik.

Ne pajtohemi me arsyet e AK-së për eliminimin e **OE Horecaks L.L.C**, pasi që siç ka konstatu edhe AK-ja i njëjti është i papërgjegjshëm, prandaj për të mos i përsëritur pretendimet tona ankimore, sqarojmë se arsyet e AK-së janë edhe pretendimet tona ankimore:

Edhe pas kërkesës për sqarime shtesë lidhur me çmimet e ofruara, arsyeshmëria e tyre nuk qëndron. Bazuar në analizën e përshkrimit të çmimeve të ofertës, konstatohet se një numër i konsiderueshëm i pjesëve/pajisjeve janë ofertuar me çmime dukshëm më të larta krahasuar me kontratën paraprake për të njëjtat apo pajisje të ngjashme, ku në disa raste çmimet rezultojnë të jenë edhe të dyfishuara brenda një periudhe njëvjeçare.

Bazuar në nenin 4 të Rregullores për Prokurimin Publik, "Administrimi i përgjithshëm i procedurave të prokurimit", pika c), Autoriteti Kontraktues ka detyrim të sigurohet që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut.

Pas shqyrtimit të çmimeve të ofruara nga ana juaj, si dhe sqarimeve shtesë të dorëzuara me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, Komisioni i Vlerësimit ka konstatuar se çmimet e ofertës suaj nuk janë në harmoni me çmimet e tregut dhe rezultojnë dukshëm më të larta në krahasim me çmimet aktuale të tregut për shërbimet e ofruara.

Rrjedhimisht, Komisioni i Vlerësimit ka arritur në përfundimin se oferta juaj nuk përmbush kriterin e arsyeshmërisë së çmimeve në përputhje me dispozitat e nenit 4, pika c), të Rregullores për Prokurimin Publik.

Ne me dt.29.05.2026, në ora 18:03 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, por që një asnjë mënyrë AK-ja nuk ka dhënë ndonjë fakt konkret që pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara.

Autoriteti kontraktues në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, është arsyetuar si në vijim:

Ne kemi kërkuar sqarime shtesë lidhur me dokumentacionin e dorëzuar, ndërsa ju keni paraqitur tri kontrata të cilat nuk kanë qenë të përfshira në listën e kontratave të dorëzuara fillimisht.

Paraqitja e dokumenteve apo kontratave që nuk janë pjesë e dokumentacionit të dorëzuar brenda afatit të përcaktuar nuk mund të konsiderohet si sqarim, por si plotësim apo ndryshim substancial i ofertës, gjë që është në kundërshtim me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe dispozitat e legjislacionit për prokurimin publik.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne nga listat e kontratave të prezantuara në ofertë e plotësojmë dhe e tejkalojmë vlerën e kontratave të përfunduara në tri vitet e fundit. Duhet sqaruar fakti se autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i ka cekur disa kontrata të cilat nuk i ka marr parasysh tek lista e projekteve të kompanisë tonë **Aly Group SH.P.K.**, ndërsa në vazhdim të arsyetimit AK-ja e ka cekur se projektet e dorëzuara nga anëtar i grupit **AR-TECH SH.P.K.**, nuk janë marr parasysh. Si arsyetim AK-ja e ka cekur si në vijim:

Sa i përket listës së kontratave të operatorit ekonomik AR-TECH shpk, kontratat e paraqitura kanë të bëjnë me furnizime, blerje dhe shërbime pastrimi, të cilat nuk kanë ngjashmëri me natyrën dhe objektin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Rrjedhimisht, këto kontrata nuk mund të konsiderohen si dëshmi relevante për përmbushjen e kërkesës mbi përvojën e ngjashme, pasi nuk dëshmojnë realizim të kontratave me objekt të njëjtë apo të përafërt me aktivitetin që kërkohet në këtë procedurë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit dhe dispozitat e Ligji për Prokurimin Publik në Kosovë.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm për faktin se e njëjta është bazuar vetëm tek titulli i kontratave, por nuk e ka analizuar në tërësi të gjithë listë.

Kur analizohet lista e projekteve të anëtarit të grupit përkatësisht **kontrata nr.1** sipas listës së projekteve, me titull **“Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e kamionëve për KMDK”**, në vlerë prej **129,920.00 euro**.

Nr	Titulli i kontrates	Nr.kontrates	Data e nënshkrimit kontrat	Data e përfundimit/pranimit te puneve te kryera	Vlera e kontrates	Personi kontaktues nga AK/menaxheri i kontrates
1	Furnizim me pjesë reserve dhe mirembajtja e kamioneve per KMDK-ne	08-08/17	08.09.2022	07.09.2025	129,920.00Euro	Burim Ismaili Burim.ismaili@kmdk-ks.org

Autoriteti kontraktues është dashur ta analizoj paramasën e këtij projekti dhe jo të thirret vetëm tek titulli i aktivitetit, pas që në këtë rast po diskriminohemi ne si kompani, ku edhe pse e plotësojmë kërkesën në lidhje me kontrata të përfunduara po eliminohemi me arsyetime të pa bazuara.

Ne edhe një herë po e sqarojmë se kërkesa e AK-së në dosje të tenderit ka qenë që operatori ekonomik të dëshmojë se ka realizuar me sukses kontrata për furnizime të ngjashme në vlerën e kërkuar. Kontrata e paraqitur nga ne me titull **“Furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtja e kamionëve për KMDK”**, përmbush këtë kërkesë, pasi objekti i saj nuk ka qenë vetëm furnizimi me pjesë rezervë, por edhe mirëmbajtja dhe servisimi i sistemeve të ndryshme teknike, elektrike, elektromekanike, elektronike dhe hidraulike. Në kuadër të kësaj kontrate janë furnizuar dhe servisuar komponentë si alternatorë, pompa, termostate, sensorë, sisteme elektrike, instalime elektrike, sisteme hidraulike, kompresorë dhe pajisje të tjera teknike, si dhe janë kryer shërbime të riparimit të sistemeve elektrike, elektronike dhe hidraulike. Këto aktivitete janë të së njëjtës natyrë profesionale dhe teknike me aktivitetet që kërkohen në kontratën për servisimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve të kuzhinave, përkatësisht me natyrën e këtij aktiviteti të prokurimit.

Pra ngjashmëria nuk përcaktohet nga emërtimi i pajisjes, por nga natyra e punimeve dhe pjesëve që servisohe. Si sqarim, frigoriferi i kuzhinës dhe sistemi i klimatizimit të kamionit përdorin kompresorë, kondensatorë, avullues, sensorë dhe kontrolle elektronike të ngjashme, prandaj përvoja në njërin sistem është relevante edhe për tjetrin, andaj kontrata e lartcekur është dashur të merret parasysh dhe jo të thuhet se kontrata është furnizim pa e analizuar fare në tërësi edhe pse edhe tek titulli shënohet **“dhe mirëmbajtja”**.

Sa për sqarim të OSHP-së, me ankesë po e bashkangjesim edhe paramasën e projektit të lartcekur.

Kriteri i dosjes së tenderit kërkon kontrata të ngjashme dhe jo kontrata të njëjta apo identike, prandaj nëse eventualisht AK-ja do të kishte kërkuar që referencat të lidhen ekskluzivisht me pajisje të kuzhinës, kjo do të duhej të ishte specifikuar qartë në dosjen e tenderit. Interpretimi i AK-së sipas të cilit vetëm kontratat që kanë për objekt pajisje kuzhine

konsiderohen të ngjashme është interpretim diskriminues për faktin se ngjashmëria duhet të vlerësohet sipas natyrës së furnizimeve dhe shërbimeve të kryera, duke u bazuar këtu në paramasat e aktiviteteve të prokurimit dhe jo vetëm sipas emërimit të pajisjes përfundimtare ku instalohen pjesët ose kryhen shërbimet.

Përveç të lartcekurave, duhet theksuar fakti se një numër i konsiderueshëm i pajisjeve të përfshira në këtë aktivitet prokurimi, si frigoriferët, frizat, vitrinat ftohëse, dhomat ftohëse, tavolinat e punës me frigorifer dhe pajisjet e tjera të ftohjes, funksionojnë mbi bazën e komponentëve dhe sistemeve të njëjta ose shumë të ngjashme me ato që përdoren në sistemet e ftohjes dhe klimatizimit të automjeteve dhe kamionëve.

Këto sisteme përfshijnë kompresorë, kondensatorë, avullues, gaz ftohës, filtra tharës, valvula ekspansioni, sensorë temperature, termostate dhe kontrole elektronike, ventilatorë, instalime elektrike dhe komponentë të tjerë të sistemit frigoriferik. Gjithashtu, servisimi dhe mirëmbajtja e këtyre sistemeve kërkon njohuri dhe aftësi profesionale në diagnostikimin e defekteve, zëvendësimin e komponentëve, kontrollimin e instalimeve elektrike dhe menaxhimin e sistemeve të ftohjes.

Prandaj, përvoja e fituar përmes kontratës së realizuar për furnizim me pjesë rezervë dhe mirëmbajtje të kamionëve nuk kufizohet vetëm në pjesët mekanike të automjeteve, por përfshin edhe sisteme frigoriferike, elektrike, elektronike dhe të klimatizimit, të cilat janë teknikisht të ngjashme me pajisjet frigoriferike dhe sistemet e ftohjes që përbëjnë një pjesë të rëndësishme të objektit të këtij aktiviteti të prokurimit.

Kur kemi parasysh të lartcekurat, kuptohet qartë se AK-ja me apo pa qëllim nuk e ka marr parasysh kontratën e lartcekur në vlerë prej **129,920.00 euro**, prandaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që ti analizojnë në detaje këto kontrata dhe pastaj të nxjerrën përfundime të sakta.

Në momentin që merret parasysh kontrata e lartcekur e anëtarit të grupit AR-Tech SH.P.K., në vlerë prej **129,920.00 euro dhe kontratat tona si lider të cilat janë krejtësisht sipas kërkesës së dosjes së tenderit, në vlerë prej më shumë se 80,000.00 euro pa i llogaritur kontratat të cilat nuk i ka marr parasysh AK-ja, atëherë ne si kompani e plotësojmë vlerën e kontratave të përfunduara prej 150,000.00 euro sa i ka kërkuar AK-ja.**

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të këtij tenderi, ndërsa anulimi i aktivitetit është në harmoni me dispozitat ligjore të LPP-së.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.2 i LPP-së. Anulimi i aktivitetit të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenin 43 të RRPP Nr.001/2022 sepse nuk janë plotësuar asnjëra prej kushteve të përcaktuara në këto dispozita duke pasur parasysh që ne jemi ofertues i përgjegjshëm.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *“Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente*, ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozitë sepse ne jemi eliminuar dhe diskriminuar pa ndonjë bazë ligjore, duke mos na rekomanduar për kontratë.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e grupit të OE **ALY Group SH.P.K; AR-Tech SH.P.K** **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim dhe ankesës në vlerë prej të paktën 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.